



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1068/1 prot.

Tiranë më 03.04.2025

Lënda: Dhënie mendimi për projektvendimin *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 742, datë 03.12.2021 të Këshillit të Ministrave ‘Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar’ (SMIP)”*.

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, *“Zyra e Komisionerit”*), ka administruar shkresën tuaj me nr. 567/5 prot., datë 26.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 1068 prot., datë 27.03.2025, përmes së cilës kërkohet mendim për projektvendimin *“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.742, datë 03.12.2021 të Këshillit të Ministrave ‘Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar’ (SMIP)”* (në vijim, *“Projektvendimi”*).

Fillimisht, nga shqyrtimi i materialit të vendosur në dispozicion, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në tërësi dhe nga përmbajtja, projektvendimi përmbush kërkesat e ligjit nr. 124/2024 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* (në vijim, *“Ligji”*), megjithatë duhet të merren në konsideratë nga ana juaj sugjerimet e mëposhtme që i referohen këtij projektvendimi.

Në projektvendim parashikohet se, SMIP do të përbëhet nga të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, të cilat kanë në përmbajtje edhe të dhëna personale, si dhe bazat e të dhënave të institucioneve të tjera me të cilët ky regjistër do të ndërveprojë.

Duke marrë në konsideratë parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, kategoritë e të dhënave që do të shkëmbehen gjatë ndërveprimit të sistemit SMIP me sistemet e palëve të treta, duhet të identifikohen në mënyrë konkrete, duke u bazuar në parashikimet e legjislacioneve respektive nga autoritetet/institucionet përgjegjëse që administrojnë këto sisteme, si dhe në përputhje me parimin e minimizimit të të dhënave personale, të parashikuar në pikën 3, të nenit 6 të Ligjit, i cili përcakton se,

të dhënat personale janë të përshtatshme e të nevojshme për qëllimin e përpunimit dhe të kufizuara në masën që është e nevojshme për realizimin e qëllimit.

Gjithashtu, në përmbajtje të pikës 6 të projektvendimit, ku përcaktohet ndërveprimi i sistemit SMIP me baza të tjera të të dhënave (p.sh. sistemin e-Matura, portali unik qeveritar e-Albania, etj.), Zyra e Komisionerit sugjeron që, në zbatim të Ligjit, konkretisht të neneve 6, 28 dhe 30 të tij, të përfshihet një pikë me këtë përmbajtje:

“Palët duhet të shkëmbejnë të dhëna personale në përputhje me qëllimin e grumbullimit të tyre, si dhe duhet të ndërmarrin masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çfarëdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. Për çdo veprim në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave, etj., duhet të sigurohet gjurmueshmëria me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave”.

Me përfshirjen e këtyre sugjerimeve, atëherë, projektvendimi do të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi